

VENDIM
Nr. 375, datë 1.6.2022

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË, NGA FONDI REZERVË I
BUXHETIT TË SHTETIT PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 25/2022, “PËR
MBËSHKETJEN DHE ZHVILLIMIN E *STARTUP*-eve”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në programin 04130 “Mbështetje për zhvillimin ekonomik”, në zërin “Shpenzime korrente” (art. 604), i shtohet fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh në buxhetin e miratuar për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për vitin 2022, për zbatimin e ligjit nr. 25/2022, “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”.

2. Efekti financiar, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj